POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

EKSKLUZIVE/ Lista me 31 të pandehurit e dosjes Balluku dhe akuzat, mes tyre 5 ndërtues e 2 firma private! Ja 9 tenderat që u manipuluan

2

Xi Jinping thirrje BE-së të bashkëpunojë me Kinën: Pekini i trajton lidhjet me sinqeritet dhe vullnet të mirë

3

Taksë për mjetet e huaja që hyjnë në vend! Sistemi do të funksionojë si në BE, pagesë për ditë qëndrimi

4

Bojkoti i avokatëve, Maks Haxhia: E ndërpresim duke nisur nga e hëna, rikthehemi në GJKKO! Do të vijojmë me padinë në Apelin e Administratives

5

'Puna juaj më në fund po vlerësohet'- Horoskopi për ditën e sotme, çfarë kanë parashikuar yjet për ju (VIDEO)

Kronikë

I dënuar për vjedhje me armë e dhunë, arrestohet në Vorë 41-vjeçari i rrezikshëm! I gjendet armë zjarri dhe jelek anti-plumb (EMRI)

41-vjeçari i arrestuar në Vorë është person me precedent penal i dënuar më parë për "Vjedhje me dhunë", "Vjedhje me armë" dhe "Armëmbajtje pa leje".

Jeleku antiplumb dhe pistoleta që ju gjetën 41-vjeçarit

Sokol Dema
30 Tetor, 09:01 | **Përditesimi: 30 Tetor, 09:29**

Share Post

Arrestohet në Vorë 41-vjeçari Elton Andreica, i njohur edhe me mbiemrin Muça.

Burime për Report Tv bëjnë me dije se ai u kap me armë zjarri pistoletë pa leje, ndërsa në momentin e ndalimit ka kundërshtuar efektivët që ishin vënë në ndjekje të tij. Ndërsa nga kontrolli në banesë iu gjet edhe një jelek anti-plumb.

41-vjeçari është person me precedent penal i dënuar më parë për "Vjedhje me dhunë," "Vjedhje me armë" dhe "Armëmbajtje pa leje".


LEXO EDHE:
Plagoset me armë zjarri 22-vjeçari në Tiranë, shpallet në kërkim autori! Sherri i nisur për shkak të një borxhi të pashlyer (EMRAT)

Ndërsa edhe më herët ka kundërshtuar forcat e policisë gjatë arrestimeve. Grupi hetimor ka dyshime se 41-vjeçari është i përfshirë në aktivitete të paligjshme, ndërsa po hetohet për përfshirje të mundshme edhe në shitjen e armëve.

> ***Njoftimi i Policisë:***
>
> *Tiranë/Finalizohet operacioni i koduar "Përfshirja".*
>
> *Sekuestrohen armë zjarri (pistoletë), jelek antiplumb, municion luftarak, mbetje të dyshuara të lëndës narkotike Kokainë, automjet dhe celular.*
>
> *Arrestohet në Marikaj, një 41-vjeçar, i cili duke qenë me masë sigurie "Arrest në shtëpi, transportonte armën e zjarrit, me qëllim trafikimin.*
>
> *Gjatë arrestimit, 41-vjeçari ka kundërshtuar me dhunë, efektivët.*
>
> *Specialistët e Sektorit për Hetimin e Narkotikëve, si rezultat i informacioneve të siguruara gjatë punës operative, finalizuan operacionin e koduar "Përfshirja", në kuadër të të cilit arrestuan në flagrancë shtetasin E. A.(M.), 41 vjeç, banues në Vorë.*
>
> *41-vjeçari u ndalua teksa drejtonte automjet, në Marikaj, duke qenë me masë sigurie "Arrest në shtëpi", për veprën penale "Goditjet për shkak të detyrës". Ky shtetas ka kundështuar me dhunë, punonjësit e Policisë, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale.*
>
> *Nga kontrolli fizik atij iu gjet 1 armë zjarri (pistoletë) me municion, të cilët dyshohet se do ta trafikonte, ndërkaq, nga kontrolli në banesë iu gjetën jelek antiplumb dhe mbetje të dyshuara të lëndës narkotike Kokainë.*
>
> *Punohet për dokumentimin e plotë të përfshirjes së shtetasit E. A.(M.) në veprimtari kriminale.*
>
> *Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Trafikimi i armëve dhe municionit", "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Goditje për shkak të detyrës" dhe "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit".*

R.Xh | **A.C** | Shqiptarja.com

TAG: vjedhje me dhune | arme zjarri | Elton Andreica | vore

Sa e vlerësoni këtë artikull? ☆☆☆☆☆

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 29 Tetor, 18:29
A besoni se TVSH-ja 6 përqind për ushqimet do të reflektohet si duhet në uljen e çmimeve?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Shkodër/ Këngëtari Taulant Hoti plagoset duke pirë kafe në lokal! Dy netë më parë performoi live (VIDEO)
27 Tetor, 11:01

Lëvizte me 4 armë pa leje në makinë, arrestohet 40-vjeçari në Vlorë! Nën hetim edhe shoqëruesi i tij, sekuestrohen 16 fishekë
18 Tetor, 12:26


Me kallashnikov e pistoletë në taksi drejt Maqedonisë së Veriut, 30-vjeçari kapet në Dibër! Armët dyshohet se i mori në Tufinë
18 Tetor, 10:56

Qëlloi me armë zjarri drejt një servisi në Kashar, pranga 30-vjeçarit! Në banesë iu gjet fenelinë e ngjashme me atë të Policisë
17 Tetor, 15:47

SHBA/ Adoleshenti vret me armë zjarri 3 fëmijë dhe një mësues brenda një shkolle fillore, ekzekutohet nga një kalimtar i rastit
16 Tetor, 17:22

Gjirokastër/ Kishte fshehur armë dhe kokainë në banesë, arrestohet 44-vjeçari! I dënuar më parë për vrasje (VIDEO)
16 Tetor, 10:10

Flogert Muça: Kur dështimi trashëgohet si armë
Flogert Muça
15 Tetor, 16:36

Kosovë/ Babai vret me armë zjarri të birin 29-vjeçar, arratiset nga vendngjarja
11 Tetor, 22:21

Gjermania kapet me armë pa leje në Kakavijë, 51-vjeçarja vihet në pranga! I sekuestrohet drogë (EMRI)
10 Tetor, 14:29


SHBA/ Të shtëna me armë zjarri në një banesë, humbin jetën 9 persona, mes tyre edhe fëmijë!
10 Tetor, 13:24


Interpol godet trafikun ndërkombëtar të armëve, 152 të arrestuar dhe mbi 2800 armë të sekuestruara! Zbulohen granata të trafikuara nga Bosnja në Serbi
9 Tetor, 18:02

Qëlloi me armë zjarri në ajër në Bulqizë, arrestohet 39-vjeçari! Policia i sekuestron automatikun, 4 krehëra dhe 47 fishekë (EMRI)
8 Tetor, 13:31

× Lajmi i fundit

Xi Jinping thirrje BE-së të bashkëpunojë me Kinën: Pekini i trajton lidhjet me sinqeritet dhe vullnet të mirë
30 Tetor, 15:20

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit

Xi Jinping thirrje BE-së të bashkëpunojë me Kinën: Pekini i trajton lidhjet me sinqeritet dhe vullnet të mirë

30 Tetor, 15:20